

V E N D I M
Nr. 64, datë 7.3.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV, KASHAR DHE PËR
LIDHJEN E TIJ ME SISTEMIN 110 KV, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve dhe bashkëpronarëve, që preken nga ndërtimi i nënstacionit elektrik 110/20 kv, Kashar, dhe për lidhjen e tij me sistemin 110 kv, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen nga KESH sh.a., në vlerë të plotë, për sipërfaqen prej 8301 m², truall në shumën e përgjithshme prej 35 694 300 (tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind) lekësh, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e miratuara për KESH sh.a-në, në kuadër të "Konventës financiare ndërmjet Qeverisë të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për "Programin e ndihmës për të mbështetur sektorët ekonomikë".

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit, në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë, të jenë në ngarkim të KESH sh.a-së, kërkuar për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit 2002.

7. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Rrethi Tiranë
Bashkia Vorë
Fshati Kashar

Lista e pronarëve të pasurisë pronë private objekt shpronësimi për interes publik "Për ndërtimin e nënstacionit 110/20kV Kashar dhe lidhjen e tij me sistemin 110 kV Tiranë"

Nr	Emër Mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Nr. parcelës	Zona kadastrale	Sip. totale m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shpenzime procedurale
1	Sefer Fucia	Yrshek Tiranë	truall	2/7	2679	25	4300	107.500	Publikime =59.000 lekë
2	Haxhi Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/10	2679	3375	4300	14.512.500 lekë	Shpërblim i anëtarëve të komisionit = 30.000 lekë
3	Agim Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/11	2679	2625	4300	11.287.500 lekë	Shpenzime kancelerie =11.000 lekë
4	Selami Luzi	Yrshek Tiranë	truall	2/12	2679	2128	4300	9.150.400 lekë	

5	Hysni Luzi	Yrshak Tiranë	truall	2/13	2679	148	4300	636.400 lekë	Totali i shpenzimeve =100.000 lekë
---	---------------	------------------	--------	------	------	-----	------	--------------	--

Shuma totale për kompensim = 35.694 300 lekë